

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E SUHAREKËS THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-Datë:	07Nr.98 datë 21.02.2023
Për:	Z.Bexhet Kuçi-Kryesues i Kuvendit Anëtareve te asamblese komunale
Nga:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim në Komunën e Suharekës Visar Kuçi
Lënda:	Njoftim rreth inicimit te procedurave për hartim te disa PRRH ne komunën e Suharekës

Të nderuar,

Pas aprovimit të Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029 dhe Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030 Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim ne bashkëpunim me drejtoritë tjera komunale është vënë në punë për implementimin e këtyre dy dokumenteve të rëndësishme për komunën tonë.

Ne si autoritet i planifikimit përmes kësaj shkrese ju përcjellim një program rreth arsytimit të kësaj iniciative me të cilën do të shpjegohet qartë nevoja e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të propozuara nga ana e jonë.

Plani Zhvillimor Komunal ashtu si Harta Zonale e Komunës i ka definuar zonat të cilat kanë nevojë për hartimin e Planeve Rregulluese, si:

1. Plani Rregullues i Hollësishëm-Zona Industriale Shirokë
2. Plani Rregullues i Hollësishëm-Zona Industriale Biraq
3. Plani Rregullues i Hollësishëm për fshatin rekreativ turistik të Dellocit

Duke iu referuar kapitullit 10 të HZK-së Arsytimi për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara, në vazhdim të kësaj shkrese jepen sqarimet e nevojshme.

1. Plani Rregullues i Hollësishëm-Zona Industriale Shirokë

- **Arsyetimi i nevojës për përgatitjen**

Ashtu si jeni në njohuri Komuna e jonë qysh në vitin 2008 ka hartuar dhe aprovuar Planin Rregullues Urban për Zonën Industriale në Shirokë. Kjo zonë është licencuar nga Ministria për Zhvillim Ekonomik, është dhënë në shfrytëzim një pjesë e madhe e parcelave të saj si dhe sot është vënë në zbatim, ku dhjetëra biznese e zhvillojnë aktivitetin e tyre në kuadër të zonës. Ndonëse kanë kaluar shumë vite që zona është dhënë në përdorim kemi raste kur zhvillime të caktuara për arsye të ndryshme kanë ndryshuar funksionin apo nuk kanë mund të realizohen në tërësi. Gjithashtu në pjesën përfundimtare të këtij lokacioni janë planifikuar hapësira për zhvillime për nevoja komunale e që kanë mbetur jashtë planit.

- **Lloji dhe përkufizimi i dokumentit të planifikimit Hapësinor**

Dokumenti emërtohet Plani Rregullues i Hollësishëm- Zona Industriale në Shirokë

- **Qëllimi i Hartimit**

Ky plan Rregullues i Hollësishëm do të shërbejë për nevoja të rregullimit, teknike dhe operacionale të planifikimit hapësinor, për të përcaktuar kushtet shtesë me të hollësishme për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nëpërmjet projekteve konkrete.

- **Kufirin e territorit**


Zona Kadastrale Suharekë, 90% pronë komunale me sipërfaqe të përafërt 163.25ha.

- **Subjekti përgjegjës për hartimin**

Bartës për procesin e hartimit të PRrH-së është autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor në koordinim me bashkëpunim me drejtoritë komunale.

- **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për hartime**

Për hartimin e dokumentit do të zhvillohen procedura në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe në harmoni me dokumentet zhvillimore dhe zonale të komunës. Financimi do të bëhet me mjete vetanake të komunës.



2. Plani Rregullues i Hollësishëm-Zona industriale Biraq

- **Arsyetimi i nevojës për përgatitjen**

Ashtu si jeni në njohuri Komuna e jonë qysh në vitin 2002 ka marr vendim mbi krijimin e një zone të re industriale në Biraq, konkretisht në zonën kadastrale të Bllacës. Zhvillimet e autostradës në atë kohë e kanë pamundësuar që kjo zonë të planifikohet me planet e vjetra zhvillimore të komunës. Ndonëse planet e reja i kanë hapur rrugë një zhvillimi të tillë komuna e sheh shumë të arsyeshme që tani është momenti i duhur që të iniciohet procedure për këtë zonë për hartimin e një plani rregullativ.

- **Lloji dhe përkufizimi i dokumentit të planifikimit Hapësinor**

Dokumenti emërtohet Plani Rregullues i Hollësishëm- Zona Industriale në Biraq

- **Qëllimi i Hartimit**

Lokacioni është i përfshirë në PZHK dhe HZK. Më HZK është i specifikuar si zonë ku do të duhej të hartohet një plan i ri rregullues i hollësishëm. Ky plan Rregullues i Hollësishëm do të shërbejë për nevoja të rregullimit, teknike dhe operationale të planifikimit hapësinor, për të përcaktuar kushtet shtesë me të hollësishme për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nëpërmjet projekteve konkrete. Realizimi i tij do të mundësoj zhvillimin e shumë bizneseve në këtë zonë (ku mundësia e qasjes me autostrade është shumë e mirë) si dhe do të krijoj të hyra të larta për komunën.

- **Kufirin e territorit**


Zona Kadastrale Bllacë, pronë komunale me sipërfaqe të përafërt 110.91ha.

- **Subjekti përgjegjës për hartimin**

Bartës për procesin e hartimit të PRrH-së është autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor në koordinim me bashkëpunim me drejtoritë komunale.

- **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për hartime**

Për hartimin e dokumentit do të zhvillohen procedura në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe në harmoni me dokumentet zhvillimore dhe zonale të komunës. Financimi do të bëhet me mjete vetanake të komunës.



2. Plani Rregullues i Hollësishëm për fshatin rekreativ turistik të Dellocit

- **Arsyetimi i nevojës për përgatitjen**

Gjate hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartës Zonale të Komunës një rendësi e veçantë i është kushtuar zonës turistike të vendbanimit të Dellocit. Ndërtimi i rrugës regjionale në drejtim të Komunës së Shtërpçës, kushtet e mira klimatike për zhvillim të turizmit janë një mundësi e mirë që këto zona të vizitohen jo vetëm nga banoret e rrethinës por nga i tërë territori i Kosovës si dhe jashtë saj.

- **Lloji dhe përkufizimi i dokumentit të planifikimit Hapësinor**

Dokumenti emërtohet Plani Rregullues i Hollësishëm për fshatin rekreativ turistik të Dellocit

- **Qëllimi i Hartimit**

Hartimi i këtij plani rregullues është i kërkuar edhe përmes Hartës Zonale të Komunës së Suharekës 2022-2030. Ky plan Rregullues i Hollësishëm do të shërbejë për nevoja të rregullimit, teknike dhe operacionale të planifikimit hapësinor, për të përcaktuar kushtet shtesë me të hollësishme për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nëpërmjet projekteve konkrete. Realizimi i tij do të mundësoj zhvillimin e turizmit në këtë zonë duke i dhënë rendësi mbrojtjes së zonës nga zhvillimet e pa kontrolluara.

- **Kufirin e territorit**


Zona Kadastrale Delloc, me sipërfaqe të përafërt 82.00 ha.

- **Subjekti përgjegjës për hartimin**

Bartës për procesin e hartimit të PRrH-së është autoriteti përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor në koordinim me bashkëpunim me drejtoritë komunale.

- **Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për hartime**

Për hartimin e dokumentit do të zhvillohen procedura në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe në harmoni me dokumentet zhvillimore dhe zonale të komunës. Financimi do të bëhet me mjete vetanake të komunës.



Me respekt

I dërgohet:

Zyrës së Kuvendit,

Dosjes së Drejtorisë,

Arkivit